



Ministria e Kulturës, Rinisë
dhe Sportit

Nr.: _____

Data: 25.11.2021

Prishtinë



Ministria e Arsimit, Shkencës,
Teknologjisë dhe Inovacionit

Nr.: _____

Data: 25.11.2021

Prishtinë



Ministria e Administrimit të
Pushtetit Lokal

Nr.: _____

Data: 25.11.2021

Prishtinë

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

ndërmjet

Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit
dhe

Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
dhe

Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal



1. Qëllimi i memorandumit

Qëllimi i këtij Memorandumi të Bashkëpunimit është mbështetja financiare për projektin: “Krijimi i rrjetit bibliotekar në Kosovë”. Projekti do të zbatohet nga 26 nëntor 2021 deri më 15 qershor 2022.

Qëllim tjetër i këtij Memorandumi të Bashkëpunimit është delegimi i përgjegjësive nga institucionet eprora te institucionet vartëse për implementimin e suksesshëm të projektit.

Përfshirja e bibliotekave të Kosovës në një Platformë të Shërbimeve Bibliotekare (LSP) do të mundësonte krijimin e një rrjeti funksional të bibliotekave më të rëndësishme të vendit; ndërtimin e katalogut të përbashkët, ku qytetarët, studiuesit, shkollarët e Kosovës dhe më gjerë do të njiheshin me libra, periodikë dhe materiale të tjera përmes katalogut të përbashkët; hyrjen e tyre në sistemet e zhvilluara bibliotekare; aftësim në përdorimin e teknologjisë, të formateve të reja dhe të njohjes me praktika rajonale dhe botërore në fushën e bibliotekarisë.

Projekt ka për objektiv, përveç të tjerash, ngritjen e cilësisë së shërbimeve të bibliotekave në Kosovë, përmes automatizimit të shërbimeve, duke punuar në rrjet, në krijimin e katalogut të përbashkët të bibliotekave në vend. Gjithashtu, ka për synim krijimin e një rrjeti të huazimit ndërbibliotekar kombëtar dhe ndërkombëtar.

2. Objektivat e projektit

Projekti-propozimi i Platformës së Shërbimeve Bibliotekare LSP (i bashkëngjitur në aktin e nënshkrimit të MB) synon të ndërtojë një rrjet të përbërë nga 1 bibliotekë kombëtare, 38 biblioteka publike, 7 biblioteka akademike dhe 2 biblioteka speciale, në krye me Bibliotekën Kombëtare të Kosovës që Ligjit Nr. 04/L-097 për Bibliotekat është qendër për koordinimin e Rrjetit Bibliotekar të Kosovës. Pas përfundimit, gjithsej 48 biblioteka do të ndajnë një sistem bibliotekar dhe një katalog, përkatësisht Katalogun e Përbashkët të Kosovës. Projekti, përveç Platformës LSP, do të ketë edhe komponenten e investimeve për përgatitjen e infrastrukturës së bibliotekave të lartcekura për përdorim të saj, e të cilat përfshijnë intervenimet e nevojshme në objektet e bibliotekave, kompletimit me infrastrukturë adekuate me pajisje të TI-së, pajisje të tjera, të cilat do të hartohen në një projekt shtojcë të këtij Memorandumi, duke vlerësuar edhe koston financiare, të harmonizuar me kërkesat e të gjitha bibliotekave. Projekti do të shërbejë si një hap për llojet e tjera të bibliotekave për t'iu bashkuar rrjetit në të ardhmen. BKK shërben si udhëheqëse e projektit dhe do të mbikëqyrë realizimin e projektit.

Objektivat specifike janë si më poshtë:

- 2.1. Konvertimi i inventarëve ekzistues ose kartë-katalogët e bibliotekave në të dhëna edhe elektronike të lexueshme nga makina të njohura si regjistrime MARC;
- 2.2. Migrimi i 48 bibliotekave në një sistem bibliotekar të avancuar me një kosto optimale;
- 2.3. Automatizimi i rrjedhës së punës në bibliotekat publike, akademike dhe speciale;
- 2.4. Ndërtimi i një katalogu modern bashkëkohor kombëtar me një shërbim kërkimi si ndërfaqe e përdoruesit që do të shfaqë/kërkojë jo vetëm koleksionet fizike të bibliotekës, por edhe burimet digjitale dhe elektronike, nëpërmjet publikimit në ueb faqe të BKK;
- 2.5. Promovimi i bashkëpunimit ndërmjet bibliotekave për zhvillimin e koleksioneve, ndarjen e burimeve, ruajtjen dhe konservimin e materialeve të rralla, huazimin ndërbibliotekar dhe rritjen e qasjes në informacion nga qytetarët brenda dhe jashtë Kosovës, për përdorim sipas politikave dhe rregulloreve në fuqi.

3. Autoritetet

Qëllim i këtij Memorandumi do të përmbushet nga:

- > Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
- > Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
- > Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Institucionet përfutuese

- > Biblioteka Kombëtare e Kosovës – përgjegjëse
- > Bibliotekat publike
- > Bibliotekat universitare
- > Bibliotekat speciale

4. Obligimet e palëve

4.1. Obligimet e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS)

MKRS merr përsipër këto obligime sa i përket qëllimit të këtij Memorandumi:

- 4.1.1. Mbështetjen financiare për Platformën të Shërbimeve Bibliotekare (LSP) nga linja buxhetore e subvencioneve, kodi 816 të Departamentit të Kulturës;
- 4.1.2. Mjetet financiare për Platformën LSP, Departamenti i Kulturës i transferon drejtpërdrejtë në kodin përkatës buxhetor (Mallra dhe Shërbime) të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës “Pjetër Bogdani” në bashkëpunim me zyrat e financave të të dy institucioneve.
- 4.1.3. Për ekzekutimin e pagesave dhe varësisht nga aktiviteti, BKK mund të aplikojë formën e dhënies së mjeteve në formë avansi apo dhe në formën finale. MKRS jep ekspertizën e nevojshme në formë të këshillave juridike e financiare për ekzekutimin e pagesave në rast se paraqitet nevoja nga BKK (pyetjet/përgjigjet me shkrim) sipas legjislacionit në fuqi.

4.2. Obligimet e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI)

MASHTI merr përsipër këto obligime sa i përket qëllimit të këtij Memorandumi:

- 4.2.1. Siguron respektimin e hierarkisë dhe përgjegjësisë institucionale te institucionet vartëse, përkatësisht te bibliotekat universitare dhe speciale;
- 4.2.2. Përcjell obligimet e nevojshme te institucionet vartëse për implementimin e projektit;
- 4.2.3. Siguron përkrahje për institucionet vartëse, Bibliotekat Universitare dhe Speciale, sidomos për mbështetje në infrastrukturën e teknologjisë informative.
- 4.2.4. Bashkë me MAPL ndan buxhetin për investimet infrastrukturore, pajisjeve të nevojshme të TI-së dhe pajisje tjera te nevojshme për implementimin e projektit në bibliotekat përkatëse sipas kërkesave të veçanta të BKK-së.

4.3. Obligimet e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL)

MAPL merr përsipër këto obligime sa i përket qëllimit të këtij Memorandumi:

- 4.3.1. Siguron respektimin e hierarkisë dhe përgjegjësisë institucionale te institucionet vartëse, përkatësisht te bibliotekat e komunave të Kosovës;
- 4.3.2. Përcjell obligimet e nevojshme te institucionet vartëse për implementimin e projektit;
- 4.3.3. Siguron përkrahje për institucionet vartëse, Bibliotekat Publike, sidomos për mbështetje në infrastrukturën e teknologjisë informative.
- 4.3.4. Bashkë me MASHTI ndan buxhetin për investimet infrastrukturore, pajisjeve të nevojshme të TI-së dhe pajisje të tjera të nevojshme për implementimin e projektit në bibliotekat përkatëse sipas kërkesave të veçanta të BKK-së.

4.4. Obligimet e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës “Pjetër Bogdani” (BKK)

BKK merr përsipër këto obligime sa i përket qëllimit të këtij Memorandumi:

- 4.4.1. BKK, me mbështetje të MKRS-së dhe në koordinim të ngushtë me Departamentin e Kulturës, zyrat e Financave dhe akterët e tjerë relevantë institucionale, pranon mbështetjen financiare;
- 4.2.1. BKK është përgjegjës për zbatimin e projektit: Krijimi i rrjetit bibliotekar në Kosovë;
- 4.2.2. BKK dokumenton të gjithë procesin në mënyrë të plotë për ekzekutimin e pagesave në kuadër të buxhetit të ndarë për këtë .
- 4.2.3. Për secilën pagesë që ekzekutohet në formën finale, obligohet të krijë/ruajë dosje të palëve të treta me dokumentacionin me sa vijon: Kopje të letërnjoftimit dhe kopje të

- kartelës bankare, për secilin person fizik të angazhuar; kopjet e dokumenteve të personave juridikë, nëse ka të angazhuar, kurse për të dyja rastet obligohet t'i pranojë dhe raportet e punës;
- 4.2.4. Për secilën pagesë që ekzekutohet në forme të avansit, obligohet të krijojë/ruajë dosje të palëve, si: Kopjen e projektit dhe kërkesën për secilin aktivitet të specifikuar si në projekt duke përfshirë dhe periudhën kohore për realizim;
 - 4.2.5. Rregullisht përcjell implementimin e projektit përmes raporteve narrative të punës, raporteve financiare dhe të tjera që mund të dalin gjatë periudhës së zbatimit të projektit dhe përbushjes së qëllimit të këtij memorandum, bashkë me ekipin menaxhues të implementimit të këtij Memorandum.
 - 4.2.6. Obligohet t'i përmbahet në përpikëri projektit të miratuar, kurse, për çdo ndryshim në projeksionin buxhetor apo si rezultat i punëve në terren, obligohet të marrë masat e nevojshme për ndryshimet në projekt në konsultim me MKRS.
 - 4.2.7. BKK obligohet që gjatë gjithë realizimit të projektit të zbatojë legjislacionin përkatës për kryerjen e aktiviteteve që dalin nga memorandum i bashkëpunimit.
 - 4.2.8. BKK është përgjegjëse për implementimin e Planit Dinamik të projektit të rrjetit bibliotekar në Kosovë, të dakorduar/aprovuar ndërmjet tri palëve nënshkruese (MKRS, MASHTI, MAPL).

5. Obligimet e përbashkëta të palëve

Palët marrin përsipër këto obligime të përbashkëta:

- 5.1. Hartimi i Planit Dinamik të projektit “Krijimi i rrjetit bibliotekar në Kosovë”, që përmban komponentët: investimet infrastrukturore, pajisjet TI, pajisje të tjera (jo të TI), platformën;
- 5.2. Realizimin e projektit dhe përbushjen e qëllimit të këtij memorandum, nëpërmjet ekipit menaxhues të implementimit të këtij Memorandum;
- 5.3. Inkorporojnë në projekt të tjera komponentë apo/dhe ndryshime që mund të përcaktohen dhe që paraprakisht duhet të shqyrtohen dhe miratohen nga palët nënshkruese të këtij memorandum duke e bërë amendamentin e këtij memorandum;
- 5.4. Shpenzimin e buxhetit sipas miratimit paraprak.

6. Zbatimi

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani” përcjellin zbatimin e memorandumit dhe udhëzojnë për veprime që duhet të ndërmerren në përbushje të obligimeve të përcaktuara në këtë Memorandum, duke caktuar ekip menaxhimi të projektit nga palët nënshkruese.

7. Mundësia e ndërprerjes së memorandumit dhe rrethanat e paparashikuara

- 7.1. Ndërprerja e Memorandumit të Bashkëpunimit bëhet më marrëveshje ndërmjet palëve;
- 7.2. Nëse implementimi duhet të ndërpritet për shkak të ndodhjeve të fuqisë mbinatyrore - Vis maior dhe rrethanave të tjera të paparashikuara, palët do të vendosin bashkërisht dhe në konsultim për veprimet që duhet të ndërmerren;
- 7.3. Afati i realizimit të qëllimit të këtij Memorandumi duhet të arrihet deri në vitin 2022;
- 7.4. Ky Memorandum i Bashkëpunimit mund të ndryshojë apo të plotësohet sipas një Marrëveshjeje me shkrim midis palëve. Përveç kësaj, çfarëdo aspekti apo kushti i caktuar që nuk është theksuar në këtë MB, për të cilat palët do të pajtohen për të hyrë në MB në të ardhmen, apo në një amendament të këtij MB-je, të nënshkruar nga palët e kësaj Marrëveshjeje, do të konsiderohen si të integruara në këtë dokument.

8. Zgjidhja në rast të mosmarrëveshjeve

Palët do të përpiqen që mosmarrëveshjet t'i zgjidhin me bisedime, mirëpo nëse nuk mund të arrijnë mirëkuptim, atëherë në rast të mosmarrëveshjes, kompetente për zgjidhjen e saj është Gjykata Themelore në Prishtinë që ka kompetencë të zgjidhë rastet e tilla.

9. Kopjet dhe gjuhët e memorandumit


Ky Memorandum i Bashkëpunimit është përpiluar në tetë (8) kopje origjinale në gjuhën shqipe. Secila palë do t'i ketë nga dy kopje origjinale të nënshkruara dhe dy kopje për BKK-në.


10. Hyrja në fuqi

Ky Memorandum i Bashkëpunimit hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët.

Për dhe në emër të
Ministrit të Kulturës, Rinisë
dhe Sportit

Hajrulla Çeku
Ministër i MKRS-së

Për dhe në emër të
Ministrit të Arsimit,
Shkencës, Teknologjisë dhe
Inovacionit

Arbërie Nagavci
Ministër e MASHTI-së

Për dhe në emër të
Ministrit të Administrimit të
Pushtetit Lokal

Elbert Krasniqi
Ministër i MAPL-së

Prishtinë,
më 25 nëntor 2021